

Delegacioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit merr pjesë në aktivitetet e organizuara me rastin e 20 vjetorit të krijimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

Një delegacion i institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit mori pjesë në aktivitetet e organizuara me rastin e 20 vjetorit të krijimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës të cilat u zhvilluan në Prishtinë, më datë 12 tetor 2023.



Konferenca tematike “Roli i Institucioneve Supreme të Auditimit në të mirë të qytetarëve” bëri bashkë drejtuesit e delegacioneve të pranishëm në këtë përvjetor duke shkëmbyer ide, qasje dhe praktikat më të mira të proceseve audituese në vendet respektive në të mirë të qytetarëve.



Kjo Konferencë ishte organizuar në dy panele. Në panelin e parë u diskutua mbi “Ndikimin e auditimit në përmirësimin e menaxhimit të financave publike”. Me këtë rast, KLSH u përfaqësua me një diskutim gjithëpërfshirës të mbajtur nga z. Qeram Cibaku, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Institucioneve Qendrore në KLSH. Gjithashtu në panel morën pjesë edhe përfaqësues nga SAI-t e Kosovës, Portugalisë, Republikës Çeke, SIGMA’s, etj.



Në panelin e dytë u diskutua mbi “Përfitimet e dixhitalizimit dhe Auditimi i Teknologjisë së Informacionit”. Në këtë panel, KLSH u përfaqësua nga z. Erald Kojku, Auditues, i cili paraqiti një ekspozitë të funksionimit të kanaleve dixhitale në Shqipëri dhe sesi është zhvilluar auditimi IT në institucionet e mëdha. Në panel diskutuan gjithashtu përfaqësues nga SAI-t e Suedisë, Letonisë, Kosovës, organizata UN Women, etj.

Në emër të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, gjatë mbrëmjes gala të organizuar, u përcoll edhe një fjalë përshëndetëse nga znj. Valbona Gaxha, Sekretar i Përgjithshëm i KLSH-së, gjatë së cilës përpos përshëndetjeve dhe urimeve të përzemërta u nënvizua bashkëpunimi i ngushtë dhe i suksesshëm ndërmjet dy institucioneve.



Delegacioni i KLSH-së në këtë event përbëhej nga znj. Valbona Gaxha, Sekretar i Përgjithshëm, znj. Marjola Llanaj, Drejtor i Përgjithshëm, z. Gjovalin Preçi, Drejtor Departamenti, z. Qeram Cibaku, Drejtor Departamenti, z. Bexhet Zeqiri, Drejtor Drejtorie dhe znj. Dëshira Huqi, Përgjegjëse Sektori.